UDHËZIM
Nr.26/1, datë 20.11.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.26, DATË 4.9.2008 "PËR TAKSAT KOMBËTARE"

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1203, datë 27.8.2008 "Për përcaktimin e vlerës së saktë, në përqindje, të rentës së pasurisë minerare, sipas vlerës së tregut, për çdo mineral apo grup mineralesh", të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare", pika 2.4 ndryshon si më poshtë:

2.4 Taksa e rentës minerare

2.4.1 Taksa e rentës minerare përcaktohet në pikën 4 të nenit 4 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave, në zbatim të tij.

Vlera e saktë, në përqindje, e rentës së pasurisë minerare, sipas vlerës së tregut, për çdo mineral apo grup mineralesh, sipas emërtimeve të shtojcës nr.2 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit, 15-ditëshin e parë të muajit shkurt të çdo viti.

Subjektet, zotëruese të lejes së shfrytëzimit të mineraleve, brenda datës 15 të muajit pasardhës, duhet të derdhin për llogari të degës së tatimeve ku ushtrojnë aktivitetin, taksën e rentës së pasurisë minerare, sipas llojit të mineralit të prodhuar (nxjerrë), sipas specifikimeve të shtojcës nr.2 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 «Për taksat kombëtare», si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave në zbatim të tij.

Kur subjekti eksporton specifikisht mineralet, sipas emërtimeve të shtojcës nr.2 të ligjit "Për taksat kombëtare" apo nënprodukte minerare (koncentrat minerali dhe produkte metalurgjike), renta minerare do të aplikohet në doganë, në momentin kur bëhet deklarata e eksportit.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dërgon në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave listën me normativat korresponduese të mineraleve të përdorura për prodhimin e nënprodukteve minerare.

Lista e normativave korresponduese të mineraleve të përdorura për prodhimin e nënprodukteve, duhet të publikohet edhe në *website*-n e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Për të gjitha nënproduktet minerare, për të cilat ka normativa të përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, organet doganore dhe tatimore do t'u referohen këtyre normativave, për përcaktimin e vlerës mbi të cilën do të llogaritet renta minerare.

a) Nëse mineralet apo nënproduktet e tyre (koncentrat minerali apo prodhime metalurgjike) destinohen për konsum final në tregun e brendshëm, renta minerare paguhet për llogari të degëve tatimore nga subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit të mineralit. Baza e taksueshme, mbi të cilën aplikohet renta minerare, është vlera e deklaruar në faturën e shitjes së mineralit nga shitësi për mineralet dhe vlera e prodhimit (nxjerrjes) të mineralit të përdorur për prodhimin e nënprodukteve, sipas normativave korresponduese për nënproduktet (për ato nënprodukte që ka normativa të përcaktuara, sipas shembullit 1 më poshtë).

b) Kur subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit është edhe eksportues minerali apo nënprodukti të tij (koncentrat minerali dhe prodhime metalurgjike), renta minerare për sasinë e eksportuar paguhet në degët doganore në momentin e bërjes së deklaratës doganore të eksportit. Pagesa e kësaj takse, në rastin e eksportit, evidentohet me mandatarkëtimi ose në deklaratën doganore të eksportit. Baza e taksueshme, mbi të cilën do të aplikohet renta minerare, është si më poshtë:

- për eksportin e mineraleve të specifikuara në shtojcën nr.2 të ligjit, vlera e faturës së shitjes së mineraleve.
- për eksportin e nënprodukteve (koncentrat minerali dhe prodhime metalurgjike) për të cilat

ka normativa korrensponduese, vlera e kostos së prodhimit (nxjerrjes) së mineralit të përdorur për këto nënprodukte. Kjo vlerë përcaktohet bazuar në sasitë e produktit përfundimtar (koncentrat apo prodhime metalurgjike), të deklaruar në doganë, si dhe normativat dhe kostot korrensponduese të mineralit të përdorur, të dërguara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, sipas shembullit të mëposhtëm:

Shembull 1. Subjekti X po eksporton një sasi 100 tonë prodhim ferrokromi nga miniera e Bulqizës, mesatarisht 39%, Cr2O3. Supozojmë se normativat korrensponduese janë respektivisht, për 1 ton ferrokrom FeCr nevojiten 2,75 tonë mineral Cr2O3 dhe kostoja e 1 ton lënde të parë (minerali) është 75 usd/tonë. Në këtë rast, përkatësisht për sasinë prej 100 tonësh ferrokrom të eksportuar janë përdoruar (100*2.75) = 275 tonë mineral *75 usd/ton =20.625 USD, pra 20.625 USD është vlera mbi të cilin do të aplikohet përqindja e rentës minerare në doganë, e konvertuar në lekë, me kursin e këmbimit të cilin aplikon dogana ditën e kryerjes së transaksionit.

c) Kur eksporti i mineralit apo nënprodukteve (koncentrat minerali apo prodhime metalurgjike) kryhet nga subjekte të cilat janë vetëm eksportuese dhe jo shfrytëzuese të mineralit (e blejnë mineralin apo nënproduktet nga një subjekt tjetër me faturë tatimore), organet doganore do të aplikojnë rentën minerare në doganë, bazuar në faturat e blerjes së mineralit apo nënproduktit të tij. Në këtë rast, subjekteve eksportuese u rimbursohet vlera e rentës minerare të paguar në doganë. Rimbursimi kryhet nga organet tatimore, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga subjekti. Dokumentacioni justifikues që subjekti duhet të depozitojë te degët e tatimeve për të marrë rimbursimin është:

1. Kopje e mandatarkëtimit të lëshuar nga dogana ose kopje e deklaratës doganore të eksportit, ku pasqyrohet vlera e rentës minerare të paguar në doganë (paraqitja vetëm e njërit prej dokumenteve është i mjaftueshëm).

2. Kopje e faturës tatimore të blerjes së mineralit nga subjekti shitës.

3. Kopje e kontratës së shitjes, të lidhur ndërmjet subjektit blerës/eksportues dhe shitësit të mineralit, koncentratit të mineralit apo prodhimeve metalurgjike.

d) Kur subjekti eksporton koncentrat minerali apo prodhime metalurgjike të prodhuara tërësisht ose pjesërisht me mineral importi, renta minerare do të aplikohet në doganë, vetëm për pjesën e mineralit të përdorur për këtë sasi eksporti, mineral i cili është blerë apo prodhuar në vend. Për pjesën e mineralit të importuar, subjekti do të depozitojë pranë degës doganore, kopjen e deklaratës doganore të importit (dy kopje), në të cilat punonjësi i doganës do të pasqyrojë sasinë e mineralit të importit, të mbetur gjendje te subjekti (nëse mbetet sasi gjendjeje) me firmën dhe vulën e doganës. Një kopje e dokumentit mbahet nga dega e doganës dhe një i kthehet subjektit për ta paraqitur në doganë, kur bëhet eksporti i radhës.

2.4.2 Për sektorin hidrokarbur, çmimi i naftës bruto mbi të cilin do të aplikohet renta minerare do të miratohet nga komisioni *ad-hoc*, krijuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005. Ministria e Financave, pas miratimit do të dërgojë për zbatim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Çmimi i naftës bruto i vlerësuar në $/fuçi, do të llogaritet me formulë të posaçme, dhe do të miratohet nga komisioni i krijuar sipas pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1203, datë 27.8.2008. Ky komision do të përdorë për llogaritjen e çmimit të naftës bruto, të dhënat e nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) ku do të merren në konsideratë cilësia e naftës bruto, graviteti i naftës bruto, përmbajtja e squfurit, përmbajtja e ujit, përmbajtja e mbetjeve, përmbajtja e fraksioneve të naftës, si dhe elemente të tjera përbërëse.

2.4.3 Për të gjitha kategoritë e tjera të nënprodukteve minerare, të cilat mund të derivojnë nga mineralet e specifikuara në aneksin nr.1 të ligjit "Për taksat kombëtare" dhe vendimin e Këshillit të Ministrave në zbatim të saj (siç mund të jenë p.sh. nënproduktet e çimentos, argjilës, naftës etj.) dhe për të cilat nuk ka normativa korrensponduese të mineraleve, të përcaktuara nga METE, kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit është njëkohësisht edhe përpunues, renta minerare do të aplikohet mbi vlerën e kostos së prodhimit (nxjerrjes) së mineralit, kosto e cila deklarohet nga prodhuesi dhe paguhet pranë organeve tatimore, sipas procedurave të mëposhtme:

a) Kur produkti është mineral i nxjerrë nga miniera dhe i shitur brenda vendit, vlera që do të merret parasysh për aplikimin e rentës është çmimi i shitjes së produktit.

b) Në rastin kur produkti përfundimtar i shitur është përpunuar më tej, vlera e mineralit është e barabartë me çmimin e shitjes së produktit përfundimtar gjatë muajit kalendarik minus:

- shpenzimet e pasurimit, shkrirjes dhe të rafinimit, që janë kryer mbi mineralin;
- shpenzimet e transportit nga miniera në fabrikën e pasurimit, shkritore ose impiantet e rafinimit të mineralit;
- të gjitha shpenzimet e tjera, të cilat nuk janë zbritur dhe që lidhen me koston e pasurimit, shkrirjes ose rafinimit.

2. Çmimi i shitjes nënkupton:

a) Në qoftë se produkti eksportohet, çmimi i shitjes është F.O.B. Shqipëri.

b) Në qoftë se produkti nuk eksportohet, çmimi i shitjes është i barabartë me çmimin e shitjes brenda vendit minus:

- shpenzimet e transportit të produktit nga pika e prodhimit deri në pikën e shitjes F.O.B Shqipëri;
- shpenzimet e tjera të shitjes, nëse ka të tilla.

Zotëruesi i lejes dorëzon brenda datës 5 të çdo muaji formularin tip nr.5, bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ai duhet të japë gjithashtu, kur është e nevojshme, edhe të dhënat e mëposhtme:

a) emrin dhe përshkrimin e mineralit;

b) emrin dhe adresën e zotëruesit të lejes dhe administratorit;

c) sasinë e mineralit të prodhuar gjatë muajit të kaluar;

d) një konfirmim lidhur me prodhimin e muajit të kaluar dhe shpërndarjen e tij (p.sh. te konsumatorët, fabrikat e pasurimit, shkritoret, rafineritë ose të depozituar);

e) sasinë e mineralit të shitur te konsumatorët gjatë muajit kalendarik, emrat dhe adresat e blerësve dhe kontratat e shitjes, të cilat duhet të përmbajnë veçoritë mbi natyrën, cilësinë dhe përmbajtjen e mineraleve;

f) emrat dhe vendndodhjet e fabrikave të pasurimit, shkritoreve dhe rafinerive ku është shpërndarë minerali;

g) koston për ton të fabrikës së pasurimit, shkritoreve dhe rafinerive ku është shpërndarë minerali gjatë muajit kalendarik;

h) koston për ton të transportit të mineralit të shitur gjatë muajit kalendarik e detajuar kjo në rastin kur transporti i mineralit kryhet duke kaluar në disa hallka transporti;

i) shpenzimet e shitjes nëse ka dhe që janë kryer gjatë muajit kalendarik;

j) një llogaritje të detajuar të rentës së pasurisë minerare gjatë muajit kalenderik.

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit duhet të mbajë pranë minierës librat përkatës të prodhimit të mineralit nga zona e lejuar dhe të gjithë dokumetacionin që lidhet me to. Të gjitha të dhënat mbi prodhimin, transportin, përpunimin dhe shitjen, përfshirë këtu dhe kontratat e shitjes, kontrollohen nga degët e tatimeve dhe doganave.

Pagesa e rentës minerare do të kryhet nga subjektet e pajisura me leje shfrytëzimi minerale, pranë organeve tatimore.

2.4.4 Kur organet doganore apo tatimore konstatojnë shmangie të dukshme të vlerës së mineralit apo nënproduktit minerar të deklaruar nga subjekti me vlerën e tregut, ato do t'u referohen vlerës së tregut për llogaritjen e rentës minerare.

Vlera e tregut për këtë kategori mineralesh apo nënproduktesh, sipas përcaktimit të pikës 7 të vendimit e Këshillit të Ministrave nr.1203, datë 27.8.2008, do të nxirret nga një komision i përbërë nga specialistë të Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Vlera e tregut, e përcaktuar nga ky komision, më pas do të dërgohen për miratim pranë komisionit *ad-hoc*, krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005.

Si burim informacioni për krijimin e dosjes me të dhënat e disponueshme për vlerën e eksporteve minerare shërbejnë burime, të tilla: si çmimet e tregjeve ndërkombëtare, të dhënat statistikore të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, investigimi i tregut, brenda dhe jashtë vendit, kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, çmimet e produkteve minerare, të

ngjashme, që eksportohen, çmimet e paraqitura në deklaratën e eksportit, për subjektet e tjera, që veprojnë në të njëjtën industri.

Në këto raste, degët doganore dhe tatimore, për llogaritjen e rentës minerare të produkteve minerare apo nënprodukteve, bazuar në vlerat e tregut, do t'u referohen vetëm çmimeve të dërguara nga komisioni *ad-hoc*, krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Formulari nr. 5

Aktrakordimi i taksës së rentËs minerare për muajin_____
Subjekti_____

Lloji i mineralit	Sasia e prodhuar	Sasia e shitur	Subjekti blerës adresa	Taksa e paguar

Administratori
(Emër, mbiemër)

Data _____